



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data



Nr. ~~28~~13
Datë:30.07.2013

Në mbështetje të nenit 30 paragrafi (1) i Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) i Rregullores së Punës Nr.20/2011 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2013,mori:

V E N D I M

1. Miratohet dhënia e autorizimit për përdorimin e karakteristikave biometrike vetëm të të punësuarëve që kanë qasje në zonën e sigurisë, e jo të punësuarëve që nuk kanë qasje në këtë zonë në Limak Kosovo International J.S.C – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”.
2. Këshillohet Limak Kosovo International J.S.C – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” që të nxjerr akt nënligjor për përpunimin e të dhënave biometrike në harmoni me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), më datë 10.04.2013, Mbikëqyrësi Shtetëror në bazë të kompetencave ligjore ka realizuar inspektim të rregullt sipas detyrës zyrtare në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” në cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrimin e aktivitetit tij.

Pas inspektimit është përpiluar procesverbali me nr.11/2013, i cili është nënshkruar nga mbikëqyrësi shtetëror dhe zyrtari përgjegjës ku të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të inspektimit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” bëhet përpunimi (përdorimi) i të dhënave biometrike i të gjithë të punësuarëve në aeroport.Përpunimi (përdorimi) i tyre, sipas zyrtarëve, bëhet për shkaqe të vijimit në punë dhe sigurisë në qasjen në zonat e kufizuara të sigurisë. Aeroporti nuk i ka bërë kërkesë Agjencisë për dhënie e autorizimit për përpunimin (përdorimin) e të dhënave biometrike.

Më datën 16.04.2013 Mbikqyrësi Shtetëror në bazë të kompetencave të tij ligjore ka nxjerrë vendimin ku ka këshilluar Aeroportin Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" që përdorimin e karakteristikave biometrike ta bëjë konform Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vendim jepet edhe arsytimi ligjor i detajuar se cilat janë kushtet e parapara ligjore për përdorimin e karakteristikave biometrike.

Më datën 27.05.2013 kontrolluesi Limak Kosovo International J.S.C - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" ka bërë kërkesë për përpunimin e të dhënave biometrike të të punësuarëve në Limak Kosovo International J.S.C - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"

Bazuar në nenin 68 (paragrafi 2), kontrollori në kërkesë ka dhënë arsyetimin se përpunimi i të dhënave biometrike të të punësuarëve bëhet për shkaqe sigurie dhe të sigurisë ,si rezultat i detyrimeve që ka Republika e Kosovës për zbatimin e legjislacionit ndërkombëtar në fushën e Aviacionit Civil ku ka përshkruar pjesët e e këtyre akteve që rregullojnë masat dhe standardet e sigurisë dhe të sigurimit të aeroporteve.Në kërkesë e paraqitur kontrolluesi ka njoftuar se Republika e Kosovës është nënshkruese e Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA),andaj të gjitha elementet e acquis communautaire të BE-së të përmendura ose përfshira në Shtojcën I DHE II të Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë dhe zëvendësojnë qdo ligj të Kosovës i cili nuk është në përputhje me to.

Kontrolluesi Limak Kosovo International J.S.C - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" në mbështetje të nenit 66 (paragrafi 1 dhe 2) të LMDHP Nr. 03/L-172,ka kërkuar lejimi i përpunimit të të dhënave biometrike (shenjat e gishtrinjëve) të të punësuarëve,me qëllim të mirëmbajtjes së nivelit të lartë të sigurisë në të gjitha hapësirat e Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" dhe si rrjedhojë e detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar të përshkruar në kërkesë.

Limak Kosovo International Airport J.S.C. ka thënë se të dhënat personale,në këtë rast të dhënat biometrike të të punësuarëve,do ti ruaj me ndershmërinë më të lartë,si dhe do të aplikoj paisjet më të avancuara të teknologjisë,për ruajtjen e këtyre të dhënave.Teknologjia aktuale që përdoret mundëson ruajtjen e këtyre të dhënave me një siguri shumë të lartë,pa lejuar ndërhyrjen nga persona të paautorizuar.

Limak Kosovo International J.S.C - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" ka siguruar se mbledhja,përpunimi,ruajtja dhe përdorimi i këtyre të dhënave do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr.03/L-172.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nenin 30(paragrafi 1) i Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur me datë xx.08.2013 ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Ruzhica JASHARI

Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror



Vendimi i dërgohet:

- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari'
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë.
- Arkivit të Agjencisë.